


gap



ecolm

KOMUNA E DEÇANIT 2017: PROBLEMET KRYESORE DHE TRENDËT BUXHETORE

Hyrje

Rasim Selmanaj në zgjedhjet e kaluara lokale në nëntor të 2013 ka arritur të fitoj mandatin e dytë për të udhëhequr me komunën. Ai në korrik të 2017 ka dhënë dorëheqje nga pozita e kryetarit duke zgjedhur pozitën e deputetit në Kuvendin e Kosovës.¹

Selmanaj në zgjedhjet e kaluara ka fituar në ruandin e parë të zgjedhjeve duke siguruar rreth 55% të votave. Kandidati i dytë në i votuar në këtë komunë ka qenë Blerim Bajraktari nga Lidhja Demokratike e Kosovës.²

Sipas një studimi të UNDP-së, 86% e qytetarëve të Deçanit konsiderojnë se komuna mund t'i zgjidhë problemet me të cilat ballafaqohen ata.³ Dy vite pas nisjes së mandatit të kryetarit Selmanaj, 58% e qytetarëve janë shprehur të kënaqur me punën e tij, përderisa vetëm 26% e qytetarëve kanë konsideruar se fondet publike në komunë menaxhohen siç duhet.⁴

Në prag të zgjedhje lokale 2013, Instituti GAP kishte identifikuar problemet kryesore të Komunës së Deçanit. Ndër problemet më madhore kishin dalë të jenë: prezenca e madhe e mbeturinave dhe deponive ilegale, prerja e pyjeve,

¹ Gazeta "Zeri". Datë 25 korrik 2017. Burim: <http://zeri.info/aktuale/154397/jep-doreheqje-rasim-selmanaj/>

² Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Rezultatet për Kryetarë Komune 2013. Burimi: <http://bit.ly/1d30foS> (Hapur më 18 qershor 2017)

³ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim - UNDP, Mozaiku i Kosovës 2015, faqe 37. Burim: <http://bit.ly/2wkuTnr> (Qasur me 14.09.2017)

⁴ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim - UNDP, Mozaiku i Kosovës 2015, faqe 91 & 92. <http://bit.ly/2wkuTnr> (Qasur me 14.09.2017)

shkatërrimi i pallatit të kulturës, mungesa e kanalizimeve në shumë vendbanime si dhe reduktimet e shpeshta të ujit të pijes.⁵

Problemet nëpër komuna janë listuar bazuar në intervista të drejtpërdrejta me përfaqësues komunal, të partive politike, shoqërisë civile, mediave dhe njohëseve të zhvillimeve lokale.

Problemet aktuale të Komunës së Deçanit

Mungesa e rrjetit të ujësjellësit

Komuna e Deçanit në katër vitet e kaluara ka shtrirë rreth 55 kilometra rrjet të ujësjellësit. Përkundër këtyre investimeve, prapë disa lokalitete përballen me mungese kanalizimi. Rjeti mungon në fshatin Maznik, Ratish e Ulet, Ratish e Eperme dhe në fshatin Sllup. Në rajonin e fshatrave të Vokshit (që ngërthen 9 fshatra) pjesërisht është instaluar rrjeti i ujësjellësit, por lidhja me burimin e ujit akoma nuk ka nodhur. Përveç mungesës së rrjetit të ujësjellësit në këto lokalitete, disa zona të Deçanit përballen me reduktime të shpeshta dhe të gjata të ujit të pijes. Me këtë problem përballen veçmas fshatrat Strellc i ulët dhe Strellc i Eperm.

Mungesa e psikologëve në shkolla

Komuna e Deçanit bënë pjesë në mesin e 11 komunave të vendit të cilat nuk kanë asnjë psikolog të angazhuar për shkolla. Ky problem është ngritur disa herë në kuvendin komunal të Deçanit, por nuk ka gjetur zgjidhje. Mungesa e psikologëve në shkolla konsiderohet hendikep në evitimin e rasteve të fëmijëve që shfaqin veprime dekuante.

Problemet nga ndërtimi i hidrocentraleve

Në komunën e Deçanit janë duke u ndërtuar dy hidrocentrale relativisht të mëdha që kanë futur në gypa një pjesë të konsiderushme të shtratit të 'Lumbardhit'. Banorët në zonën e quajtur Gryka e Deçanit kanë kundërshtuar ndërtimin e këtyre hidrocentraleve. Komuna është arsyetuar se lejet për ndërtim dhe operim të këtyre hidrocentraleve janë dhënë nga niveli qendror. Komuna nuk ka përfitim nga këto hidrocentrale. Për krahasim, në Komunën e Shterpçës ka nsiur ndërtimit i një hidrocentrali të tillë, por komuna e ka obliguar kompaninë që 50% e rrjetit të ndriçimit publik duhet të mbulohet me energji nga ky hidrocentral si formë e kompenzimit për ndërtimin e e saj.

Dëmtimi i resurseve natyrore të "Podi i Gështenjave"

Komuna e Deçanit është e njohur për resursin e pasur natyror të prodhimit të gështenjave. Këto plantacione natyrore janë të koncentruara veçmas në zonën e quajtur "Podi i Gështenjave". Kjo zonë i është nënshtruar degradimit.

⁵ Instituti GAP, Komuna e Deçanit: Problemet kryesore dhe trendët buxhetore. Shtator 2013. Burimi: <http://bit.ly/2hapZaq>

Mbeturinave të hedhura në këtë vend u vihet zjarri, duke shkaktuar ndotje të ambientit dhe shtëpive përreth. Zona e quajtur “Podi i Gështenjave” është atraksion i veçantë natyror i Deçanit dhe dhjetëra familje nga kjo komunë i sigurojnë të ardhurat e tyre nga mbledhja dhe shitja e gështenjave që janë të shumta në këtë zonë.

Prerja e pyjeve

Njëri ndër problemet më të theksuara në Komunën e Deçanit është shkatërrimi i vazhdueshëm dhe sistematik i pyjeve nga prerja ilegale e tyre. Nga prerja nuk janë kursyer as pishat e mbjella dekada me herët. Fshatrat që konsiderohen me të prekura nga kjo dukuri janë malet në Beleg, Baballoqit, Isnici, Prilepit, Rrznici, Voksh dhe Dashinoc.

Mos përfundimi i rrugës Deçan-Plavë

Kjo rrugë lidh rajonin e Deçanit me fshatrat të banuara me shqiptarë në Mal të Zi. Ka nisur në vitin 2014 dhe kanë përfunduar vetëm 500 metra. Përfundimi i këtij segmenti konsiderohet me rëndësi për zhvillimin e turizimit, hapjen e një pikëkalimi të ri kufitar që do të mundësonte zhvillimin e ekonomive të vogla. Punimet në rregullimin dhe asfaltimin e kësaj rruge janë ndërprer në fillim të 2016 dhe nga atëherë nuk ka pasur lëvizje tjera në finalizimin e projektit që në kohën e inaugurimit të punimeve është vlerësuar me interes nacional.

Fushat që kërkojnë vëmendjen e komunës

Zhvillimi i turizimit

Komuna e Deçanit e ka hapur një zyre informuese për turistët. Por, përkundër resurseve të mëdha në zhvillimin e turizimit nuk ka pasur investime me rëndësi në këtë drejtim. Ndonëse komuna investimet në infrastrukturë i konsideron si faktor i zhvillimit të këtij resursi. Deçani njihet për nga bukuritë natyrore si Gryka e Deçanit, Bjeshka e Belegut por edhe nga trashëgimitë kulturore ku përfshihen shumë monumente kulturore, historike dhe arkeologjike. Andaj promovimi i kësaj trashëgimie paraqet faktor me rëndësi në zhvillimin e turizmit.

Ndertimi i këndeve për fëmijë dhe i hapësirave rekreative-sportive

Në të gjitha zonat urbane të komunës së Deçanit ka mungesë të këndeve për fëmijë si dhe i hapësirave rekreative-sportive. Komuna do të duhet në katër vitet e ardhshme t’u kushtoj vëmendje këtyre mungesave dhe të investoj në zbutjen e kësaj gjendje.

Trendet Buxhetore në Komunën e Deçanit – 2017

Komuna e Deçanit në vitin 2017 ka planifikuar 8.2 milionë euro buxhet.⁶ Në këtë buxhet do të barten nga viti 2016 edhe 215 mijë euro të tjera nga të hyrat vetanake të pashpenzuara.⁷ Krahasuar me buxhetin e planifikuar të vitit 2013*⁸, kur ishte koha e zgjedhjeve lokale, buxheti i Komunës së Deçanit është rritur për 1.8 milionë euro. Kjo rritje në masë të madhe buron nga rritja e granteve qeveritare.




FIGURA NR.1: BUXHETI I KOMUNËS SË DEÇANIT 2017

Së bashku me rritjen e buxhetit janë rritur edhe shpenzimet në kategorinë e pagave, investimeve kapitale dhe mallrave dhe shërbimeve. Rritje më e theksuar e buxhetit është bërë në kategorinë e pagave (5.1 milionë euro), ku nga viti 2013 janë rritur shpenzimet për rreth 1.1 milionë euro, dhe atë të shpenzimeve kapitale që tani ngërthen 700 mijë euro më shumë (2.1 milionë euro). Ndikim të madh në rritjen e buxhetit për paga kishte vendimi i Qeverisë së Kosovës i vitit 2014 për rritjen e pagave në sektorin publik për

⁶ Shih për më shumë platformën buxhetore të Institutit GAP në <http://bit.ly/2qstB7G> dhe Ligjin Nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017.

⁷ Ministria e Financave. Raporti Financiar 2016. Burimi: <http://bit.ly/2eFtgKj>, faqe 63 (hapur më 6 shtator 2017).

*Në këtë vit mjetet e bartura nga të hyrat e pashpenzuara ishin më të ulëta se në 2017 për rreth 130 mijë euro. Shih Raportin vjetor financiar 2012. Ministria e Financave. Burimi: <http://bit.ly/2wKArJf>, faqe 60.

⁸ Shih Ligjin Nr. 04/L-165 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013.

25%.⁹ Po ashtu, angazhimi i 19 punonjësve të rinj¹⁰ në periudhën 2013-2016 ka bërë që shpenzimet për paga të rrisin pjesëmarrjen e tyre në buxhetin vjetor të komunës.




FIGURA NR.2: TRENDET BUXHETORE TË DEÇANIT MË 2013 DHE 2017

Komuna e Deçanit gjatë vitit 2016 ka pasur të hyra vetanake në vlerë prej 673 mijë euro, ku vërehet një trend rritës në arkëtimin e të hyrave që nga viti 2013.¹¹ Kategoria e të hyrave që kontribuon më shumë në buxhetin e Deçanit mbetet ajo e tatimit në pronë.¹² Rritje më e theksuar në të hyrat vetanake Deçani kishte më 2015, ku për dallim nga 2014 të hyrat janë rritur për afro 45%. Kategoria me kontributin më të madh në të hyra më 2015 ishte ajo e taksës komunale për ndërtim (220 mijë euro).¹³

⁹ Zyra e Kryeministrit, Vendimet e mbledhjes së 172-të të qeverisë. Burimi:

<http://bit.ly/2w6MK0M> (hapur më 6 shtator 2017).

¹⁰ Ministria e Financave. Raporti Financiar 2016. Burimi: <http://bit.ly/2eFtgKj> (hapur më 6 shtator 2017).

¹¹ Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti për Komunën e Deçanit 2016. Burimi: <http://bit.ly/2xbdq2i> (hapur më 6 shtator 2017).

¹² Ibid. Faqe 18.

¹³ Kuvendi Komunal në Deçan. Të hyrat 2015. Burimi: <http://bit.ly/2xfP4Gn> (hapur më 6 shtator 2017).




FIGURA NR.3: TRENDET BUXHETORE TË DEÇANIT MË 2013 DHE 2017

Krahasuar me vitin 2017, sipas vlerësimeve në ligjin për buxhetin 2017¹⁴, buxheti i Komunës së Deçanit pritet të rritet jo më shumë se tre përqind më 2018 (8.4 milionë euro) dhe pesë përqind më 2019 (8.6 milionë euro). Këtë rritje Deçani planifikon ta orientojë kryesisht në arsim, bujqësi dhe zhvillim ekonomik. Po ashtu vërehet tendencë e ndryshimit të pjesëmarrjes së disa programeve në buxhet, sikurse ulje e buxhetit të programit për investime kapitale.

Rekomandimet

Duke u bazuar në problemet kryesore dhe trendet buxhetore, Instituti GAP rekomandon që qeverisja e komunës e dalë nga zgjedhjet lokale të 2017 të ndërmerr këto veprime:

- Komuna e Deçanit duhet t'i angazhoj psikolog/e në shkollat e komunës.
- Komuna duhet të shtrij rrjetin e ujësjellësit në fshatrat ku aktualisht ky rrjet mungon dhe njëherazi të bëjë funksional rrjetin që e ka instaluar deri tani.
- Komuna duhet të ndërmarr masa urgjente në mbrojtjen e zonës së quajtur "Podi i Gështenjave".
- Komuna duhet të shoh zhvillimin e turizmit me prioritet.
- Komuna duhet t'i shtoj investimet në fushën e sportit, rinisë dhe në ndërtimin e këndeve për fëmijë.

¹⁴ Ligji Nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017, faqe 236.



Instituti GAP është think-tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

Ky projekt mbështetet nga:



**National Endowment
for Democracy**

Supporting freedom around the world